Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 1/1.**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët]

**FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njësi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

*Specifikimet Teknike për Blerje P/N dhe shpenzime mirembajtje per sistemin e Radarit te Porto Romanos, Indra*

### PARATHËNIE

Agjensia Kombëtare e Trafikut Ajror (shkurt "ALBCONTROL") po e boton këtë RFP (Request For Proposal) për të përfituar ofertën e çmimit konkurues nga firma prodhuese ose nënkontraktor të saj që do të ofrojnë shërbimet më të mira për Mirëmbajtje dhe Blerje pjesë rezervë për pajisjen radarit (INDRA) në stacionin e Porto Romano.

### Të Drejtat e Përdorimit të Këtij Dokumenti

Ky Dokument dhe të gjitha informacionet e marra lidhur me këtë RFP janë informacion i ALBCONTROL, që ofertuesi ose persona të tjerë që bien në kontakt me këtë dokument nuk



---

duhet ta zbulojë me asnjë palë të tretë, përveç rastit kur mund të jetë e nevojshme për të përgatitur ofertën e tyre.

Ofertat e marra nga ALBCONTROL do të trajtohen si konfidenciale dhe nuk do t'i shpërndahen asnjë pale të tretë përtej Agjencisë së ALBCONTROL-it.

## **Përmbajtja e dokumentit**

- 1. Përshkrim**
- 2. Mirëmbajtje parandaluese**
  - 2.1 Aktivitetet e mirëmbajtjes parandaluese
- 3. Mirëmbajtje korrektive (sipas kërkesës)**
- 4. Sigurimi i pjesëve rezervë**
- 5. Plani i prodhuesit për Vazhdimesinë e Biznesit në kushte të veçanta**
- 6. Perditesim i SRG and SLG**
- 7. Trajnim teknik për inxhinieret e SUR**

### **1. Përshkrim**

Duke u bazuar në rregulloren e brendshme të Sektorit CNS, procedurave të mirëmbajtjes së pajisjeve të survejimit, urdhrit të brendshëm Nr 2847/1 datë 09.12.2022 për përgatitjen e specifikimeve teknike me qëllim realizimin e kontratës me objekt "Blerje P/N dhe shpenzime mirëmbajtje për sistemin e Radarit të Porto Romanos, Indra" dhe për të garantuar shërbim të vazhdueshëm brenda parametrave të cilësisë së pajisjes në fjalë të përcaktuara nga prodhuesi dhe gjithashtu nga institucionet ndërkombëtare propozojmë lidhjen e kontratës së mirëmbajtjes të detajuar si në pikat vijuese.

Në rast se kontrata nuk lidhet me prodhuesin e radarit MSSR Porto Romano, atëherë çdo nënkontraktor tjetër, subjekt i kontratës, duhet të shpreh në mënyrë të qartë aftësitë e tij në lidhje me operimin dhe riparimin e sistemit të radarit MSSR Porto Romano. Nënkontraktori në fjalë, në rast se nuk ka lidhje të drejtëpërdrejtë me prodhuesin, duhet të garantojë ALBCONTROL mbi çertifikimin dhe eksperiencën e duhur të punonjësve që do të vendos në dispozicion të kësaj kontrate. Në këtë aspekt, nënkontraktori duhet të paraqesë pranë ALBCONTROL dokumentacionin duhur për të treguar se është i çertifikuar nga ana e firmës prodhuese INDRA, për të kryer çdo lloj shërbimi për sa i përket mirëmbajtjes së radarit MSSR Porto Romano. Gjithashtu stafi që do të vihet në dispozicion të zbatimit të kësaj kontrate, për sa i

---

përket pjesës së mirëmbajtjes parandaluese dhe asaj korrektive duhet të kenë një eksperiencë pune jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e operimit dhe zgjidhjes së problematikës së radarit INDRA MSSR Porto Romano.

Nenkontraktori duhet të dorëzojë certifikatën e autorizimit të prodhuesit INDRA për kryerjen e aktiviteteve të kërkuara në kontratë sipas afateve dhe kohëzgjatjes.

## **2. Mirëmbajtje preventive vjetore**

Mirëmbajtja preventive është një faktor shumë i rëndësishëm për të garantuar performancën e radarit gjatë gjithë jetëgjatësisë së tij. Për realizimin e mirëmbajtjes preventive zbatohen procese të caktuara Javore / Mujore / Vjetore, prej të cilave dy te parat aplikohen nga specialistet e Survejimit në Albcontrol sipas procedurave të përshkruara në manualin e pajisjes, ndërsa procedura Vjetore që është pjesë e kësaj kontrate Mirëmbajtjeje Vjetore zbatohet nga specialistët e firmës prodhuese së radarit (INDRA) në stacionin e Porto Romano ose nga stafi i firmes nenkontraktore i cili plotëson kriteret e përmendura më lart.

INDRA/nenkontraktori do të ndërmarre këtë procedurë mirëmbajtjeje preventive duke sjellë në stacionin e vendodhjes së radarit MSSR Porto Romano 2 Inxhinierë për një periudhë 5 ditore gjatë kohës zyrtare të punës (8 orë në ditë) duke përfshirë të gjitha shpenzimet lidhur me këtë proces (udhëtim, akomodim, transport, shpenzime postare etj. ) Personeli i INDRA/Nenkontraktorit në bashkëpunim me specialistët e Albcontrol do të kryejnë procedurat përkatëse të mirëmbajtjes duke bërë njoftimin dhe duke marrë konfirmimin paraprak 1 muaj përpara fillimit të mirëmbajtjes së planifikuar, e cila duhet të kryhet duke zvogëluar në minimum kohën e ndërprerjes së shërbimit.

Kërkohet që gjatë një vizite në stacionin e radarit të ofrohen shërbimet e mëposhtme:

- a) Matja e performancës së radarit para fillimit të procedurave të mirëmbajtjes duke përdorur rregjistrimin nga radari për një numër kampionesh sipas specifikimeve.
- b) Kryerja e mirëmbajtjes vjetore konform përshkrimeve në këtë dokument, specifikimeve në manualin e pajisjes dhe praktikave standarde të INDRA.
- c) Korrektimi i problemeve të evidentuara nga Albcontrol dhe INDRA/Nenkontraktori si për hardware dhe software. Për pajisjet e dëmtuara do të perdoren pjesë rezervë nga Albcontrol.
- d) Është e domosdoshme që gjatë Mirëmbajtjes Preventive të jetë prezent edhe stafi i Albcontrol për të rifreskuar njohuritë nga trajnimet e marra dhe për të përfutur eksperiencë në zhvillimin e procedurave të mirëmbajtjes.
- e) Matja e performancës së radarit në mbyllje të procesit të Mirëmbajtjes dhe krahasimi i rezultateve.

---

Shënim: treguesit e performancës së radarit në mbyllje të procesit së Mirëmbajtjes duhet të kenë vlera më të larta ose të jenë të barazvlefshme me ato që kanë rezultuar pas matjes fillestare.

f) Veprimet kryesore që aplikohen gjatë procedurës së Mirëmbajtjes preventive janë:

- Inspektimi visual i stacionit të Radarit.
- Inspektimi i antenës, kabllimit dhe pedestalit.
- Matja e burimeve të ushqimit.
- Verifikimi i Master Clock.
- Matja e frekuencave.
- Fuqia maksimale dhe funksioni ISLS.
- Matja e ndjeshmërisë dhe numri i pulseve të gabuara.
- Detektimi.
- Dynamic range.
- Verifikimi i tabelës Monopulse.
- Verifikimi i grafikëve GTC.
- Verifikimi i RSLs.
- Procesimi i 4 përgjigjeve të njëkohësishme.
- Gjurma e targetit.
- Sinkronizimi.
- Komutimi i kanaleve.
- Sinjalet ACP dhe ARP.
- Mirëmbajtja UCS.
- Mirëmbajtja SLG.
- Mirëmbajtja SRG.
- Analizim performance me SASS-C.

g) Përpilimi i raportit për veprimet e kryera dhe performanca e pajisjes. Rezultatet e marra dhe testimet e kryera.

Në përfundim të procesit INDRA/Nenkontraktori duhet të përgatisë raportin përmbledhës, i cili përfshin aktivitetet e kryera gjatë vizitës së Mirëmbajtjes Preventive si dhe rezultatin përfundimtar. Ky rezultat duhet të firmoset nga të dy palët e INDRA/Nenkontraktori dhe Albcontrol. Raporti final do të dërgohet jo më vonë se 10 ditë pune nga data e finalizimit të largimit nga stacioni i radarit. Në raportin final duhet të përfshihet dhe jetegjatesia, periudha që prodhuesi suporton me pjesë rezerve dhe suport teknik sistemin e radarit të Porto Romanos (life cycle).

### 3. Mirëmbajtje Korrektive (sipas kërkeses)

---

Gadishmëria për vizitë emergjence në site duhet të kryhet brenda një kohë të shkurtër (5 ditore) për të riparuar difektet e sistemit dhe rikthimin në gjendje normale pune.

Për të pasur mbështetje të vazhdueshme teknike për sa i përket zgjidhjes së difekteve emergjente në rastet kur :

- a) Albcontrol kërkon një vizitë në stacion për të zgjidhur me emergjencë një problem në radarin MSSR Porto Romano nëpërmjet një shkrese zyrtare, emaili nga Menaxheri i Projektit apo nëpërmjet një thirrje telefonike.
- b) INDRA/Nenkontraktori vlerëson që ndërhyrja nuk mund të realizohet me suport nga distanca apo me ndërhyrjen e stafit lokal.

INDRA/Nenkontraktori do të dërgojë një specialist për të zgjidhur problemin në stacion brenda një periudhe shumë të shkurtër, kur nuk ka arsye madhore që pengojnë realizimin e kësaj vizite duke planifikuar logjistiken përkatëse.

INDRA/Nenkontraktori duhet të garantojë mundësinë e të pasurit gadishmëri specialistët përkatës për hardware dhe software dhe duhet të rezervojë një përgjigje pozitive për këto raste.

Duke qënë se ky proces pune është Sipas Kërkeses, INDRA/Nenkontraktori duhet të paraqesë një metodë faturimi mundësisht për njësi, ditë / orë pune / shpenzimi, udhëtimi etj.

#### 4. Sigurimi i pjesëve rezervë

Magazinimi i pjesëve rezerve është i nevojshëm për të garantuar funksionimin pa ndërprerje të sistemit të radarit të MSSR Porto Romano edhe në rastin kur defektohet një nga komponentët e sistemit. Si pasojë e kësaj kërkesë duhen siguruar pjesët e mëposhte:

Emri i pjesës	Kodi / Lloji	Sasia	Shënime
RF UTS Module	MD20750030900	1	Duhen siguruar pajisje të reja.
Pedestal ARP Discriminator	11270000400	1	Duhet siguruar një pajisje e re ose të rregullohet ajo ekzistuese

A1 CPU-30 Card Assembly	CE10750076100	1	Duhet siguruar pajisje të reja.
A6 SEC Card Assambly	CP095139200A0	1	Duhet siguruar një pajisje e re ose te rregullohet ajo ekzistuese.
A9 COD Card Assambly	CP096156200A0	1	Duhet të riparohen ato ekzistuese.
A10 IRE Card Assembly	CP096156100A0	1	Duhet të riparohet ajo ekzistuese.
A4 UTS Replies Gen Card Assambly	CP0850311AA00	1	Duhet siguruar pjesë e re, ose të riparohet ajo ekzistuese.

Tabela 3: Pjesët rezervë

a. Metoda e marrjes ne dorrezim te pjeseve rezerve apo riparuar do te jete si me poshte: Pjeset per riparim do te dorezohen direkt pas nenshkrimit te kontrates tek firma e kontraktuar. Riparimi dhe dorezimi i tyre ne Albcontrol duhet te behet jo me vone se 4 muaj nga kjo date.

Ne momentin e dorezimit me pranine e kontraktorit apo nje personi te caktuar prej tij do te testohen pjeset e sjella ne sistemi MSSR ne nje orar te pershtatshem nga Albcontrol per te kryer kete aktivitet.

Te gjitha pjeset qe funksionojne ne menyre te rregullt pas testimit do te konfirmohen me proces verbal per pagesen sipas kushteve te kontrates.

b. Konfirmimi i sherbimeve do te realizohet pas dorrezimit te raportit te mirembajtjes ne site nga prodhuesi.

c. Prodhuesi duhet ti jape Albcontrol nje liste te plotë cmimesh për riparimet apo ndërrimet e pjesëve te difektuara lista do të japë cmimin për njesi si dhe duhet të jetë e vlefshem për të gjithë periudhen e mirëmbajtjes. Albcontrol do të ketë të drejten të porosise riparimin e pjeseve nese ka nevojë me çmimin e deklaruar paraprakisht nga kontraktuesi.

d. Albcontrol do te vendose nese do bleje apo riparoje pjeset e demtuara

---

## **5. Plani i prodhuesit per Vazhdimesine e Biznesit ne kushte te vecanta**

- 1- Kontraktori/prodhuesi duhet te ndaje me Albcontrol planin e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit ne kushte te vecanta. Business Continuity Plan.
- 2- Kontraktori duhet te evidentoje metoden e punes dhe kriteret minimale te ofrimit te sherbimit ne raste te vecanta si psh pandemie, ndalim te levizjes ndershtetase, demtime te asetave apo infrastruktures per shkaqe madhore.

## **6. Perditesimin i SRG dhe SLG**

Prodhuesi/nenkontraktori duhet te perditesoje sistemet e monitorimit SRG dhe SLG nga ana Hardware dhe Software.

## **7. Trajnim teknik per inxhinieret e SUR**

Prodhuesi ose nenkontraktori duhet te siguroje trajnim minimumi 5 ditor (prezence lokale) per pjeset e Radarit te Porto Romanos.

Trajnim i hollësishëm mbi administrimin dhe mirëmbajtjen e Radarit në nivel 1 dhe 2 sipas EASA 373

Vlerësimi njohurive në fund të trajnimit bëhet me çertifikim nga prodhuesi

---

## **Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet: Sipas shtojces se specifikimeve teknike**

**Afatet e lëvrimit: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i kontratës.**

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përfshirë nga drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

#### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.



---

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë

##### 2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional: Sipas kriterëve të përgjithshme për kualifikim

##### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2019-2020-2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit

2.2.2 Bilancet e viteve (2019-2020-2021) miratuar nga organet perkatese shtetore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

##### 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata ku të ketë realizuar shërbime të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllëguar të kontratës që prokurohet, të realizura gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar si dhe pikës 4/b, nenit 40/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021

---

*“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit besueshmërinë të Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet:

- **ISO 9001:2015**, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerise.
- **ISO/ IEC 27001-2013**, Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Informatike ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerise.

Certifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, ose ekuivalente me to.

***Argumentimi:** Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

*Sqarojmë se Albcontrol sha, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregullores Europiane 1035/2011 dhe të audituar nga ana e Agjensisë Europiane të Sigurisë së aviacionit (EASA) çdo dy vjet, ndërkohe sistemet me të cilët operon duhet të jenë komptibël me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtare të Aviacionit Civil sipas Rregullores së Komisionit European EC 552/2004 si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative.*

*Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit dhe në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve.*

2.3.3 OE, duhet të kete Autorizim nga prodhuesi ose distributore të autorizuar nga prodhuesi për mirëmbajtjen e Sistemin të Radarit MSSR. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, gjithashtu AK ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave të Autorizimit të prodhuesit të Radarit

***Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77/2 të LPP: Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Informacione për nënkontraktorin</b></li> </ul>
---

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
  - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
  - a) çmimet ;
  - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
  - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
